



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 69, Datë 26.03.2018

MBI

REFUZIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “M.T.C ENERGY” SH.P.K, PËR LËNIEN PENG NË FAVOR TË RAIFFEISEN BANK SH.A. TË ASETEVE TË SAJ, PËR EFEKT TË RISTRUKTURIMIT TË KREDISË.

Në mbështetje të neneve 16; 20 pika “a” dhe 44, pika 1, të ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; neneve 104 dhe 113 të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe në zbatim të neneve 7; 10 pika 2 dhe 11 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licensuarit” të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr.119, datë 21.07.2016; pikës 1.3 dhe 1.6 të “Licencës për Prodhimin e Energjisë Elektrike”; miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 99, datë 17.06.2016; nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 26.03.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi refuzimin e kërkesës për lënie peng të aseteve të shoqërisë MTC Energy sh.p.k. pranë Raiffeisen Bank, për efekt të ristrukturimit të kredisë,

Konstatoi se:

- Shoqëria “M.T.C Energy” sh.p.k., me shkresën e datës 22.12.2017, protokolluar në ERE me nr. 817/2 Prot, datë 28.12.2017, ka kërkuar miratimin për lënie peng të aseteve të luajtshme dhe të pa luajtshme që disponon, në favor të “Raiffeisen Bank” sh.a, për efekt të ristrukturimit të kredisë dhe për garantimin e detyrimeve të kredisë të marrë nga kjo bankë në datë 28.02.2012.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 12, datë 10.01.2018, filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “M.T.C Energy” sh.p.k., për lënie peng të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të shoqërisë, në favor të Raiffeisen Bank sh.a., për efekt të ristrukturimit të kredisë së dhënë.
- Mbas vendimmarrjes së sipërcituar, me shkresën nr. 18/2, datë 22.01.2018, është njoftuar subjekti “M.T.C Energy” sh.p.k lidhur me këtë vendim të bordit si dhe me shkresën nr. 18/3 Prot, datë 07.02.2018, i është kërkuar që brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës të depozitojë në ERE dokumentin e miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për lënie peng të aseteve në favor të Raiffeisen Bank.

- Shoqëria me shkresën datë 19.02.2018, (protokolluar me tonen nr. 18/4 datë 22.02.2018), bën me dije se me shkresën e datës 13.02.2018, i është drejtuar MIE me kërkesën për dhënien e miratimit për vendosje hipoteke dhe barrë mbi asetet e shoqërisë “M.T.C Energy” sh.p.k, për efekt të ristrukturimit të kredisë në favor të bankës “Raiffeisen Bank” sh.a.
- Pas përfundimit të afatit të kërkesës për plotësim dokumentacioni sa sipërcituar, ERE ka ripërsëritur kërkesën për plotësim dokumentacioni me shkresën nr. 18/5 Prot, datë 02.03.2018.
- Nga ana e subjektit nuk është depozituar dokumentacioni i munguar dhe i kërkuar nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të refuzojë kërkesën e shoqërisë “M.T.C Energy” sh.p.k, për miratimin e lënies peng në favor të Raiffeisen Bank sh.a. të aseteve të saj, për efekt të ristrukturimit të kredisë dhe të shfuqizojë vendimin e Bordit të ERE nr. 12, datë 10.01.2018, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “M.T.C Energy” sh.p.k., për lënien peng të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të shoqërisë, në favor të Raiffeisen Bank sh.a., për efekt të ristrukturimit të kredisë së dhënë.”
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.